



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1574/1 Prot.

Durrës, më 27.10.2022

VENDIM

Nr. 63 Datë 27/10/2022

PËR

**NJË SHITESË NË REGJISTRIN E PARASHIKIMEVE TË PROÇEDURAVE TË
PROKURIMIT PUBLIK, PËR VITIN KALENDARIK 2022"**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar regjistrin të parashikimit të procedurave të prokurimeve publike për vitin kalendarik 2022, miratuar me vendim të Bordit të Administrimit Nr.7 datë 18.02.2022 me Nr. 308/5 Prot datë 18.02.2022, shkresës Nr. 5164/1 Prot, datë 02.08.2022 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me objekt "Njoftim mbi projektet e miratuara, për vitin akademik 2022-2023", Vendimit Nr. 52 datë 08.09.2022 të Senatit Akademik, Vendimit Nr. 42 datë 14.09.2022 të Bordit të Administrimit, kalendarit të aktiviteteve për realizimin e projektit të Ndërkombëtarizimit me temë Diplomë e dyfishtë në ciklin e tretë të Studimeve, Doktoratë në Shkenca Edukimi në "Administrim Publik" dhe në "Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik", bazuar në kërkesat e drejtuesve të projekteve për blerjen e paisjeve elektronike në kuadër të projekteve të Ndërkombëtarizimit, Senati Akademik në mbledhjen e datës 27.10.2022,

VENDOSI:

1. Ti propozojë Bordit të Administrimit shtimin e objektit të prokurimit në regjistrin e parashikimit të prokurimit publik të vitit kalendarik 2022 të objektit "Blerje paisje elektronike në kuadër të projekteve të Ndërkombëtarizimit" me vlerë totale 15.000.000 (pesëmbëdhjetë milion) lekë.
2. Burimi i Financimit do të jetë : Nga Buxheti i Shtetit.

Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim përfundimtar.

KRYETAR

Prof. Dr. Kscanela Sotirofski

